



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 60, Datë 16.02.2021**

**PËR**  
**PËRFUNDIMIN PARA AFATIT TË SHËRBIMIT NË SKEMËN E DELEGIMIT,**  
**PËR GJYQTAREN ZNJ.{...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61 dhe 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 45, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “c”, pika 2, neni 14, të Vendimit të tij nr. 22, datë 07.02.2019, “Mbi miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurën e funksionimit të skemës së delegimit të gjyqtarit”, në kushtet kur për gjyqtaren e skemës së delegimit znj.{...} verifikohet ndërprerja e përkohshme e ushtrimit të funksionit të gjyqtarit për shkak të pezullimit nga detyra me Vendimin e tij nr.315, datë 14.09.2020, mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

**VENDOSI:**

1. Përfundimin para afatit të shërbimit në skemën e delegimit, për gjyqtaren znj.{...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarës znj.{...}, sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare dhe atë të depozituar nga vetë ajo, si edhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe Gjykatës së Apelit Korçë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**